

V E N D I M
Nr.6, datë 29.12.1992

PËR LIKUIDIMIN E PAAFTËSISË PAGUESE TË NDËRMARRJEVE SHTETËRORE

Për të përmirësuar gjendjen e vështirë financiare të ndërmarrjeve shtetërore, në mbështetje të marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Bankës së Shqipërisë, Bankës Kombëtare dhe Bankës së Bujqësisë dhe të Zhvillimit, me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Banka Kombëtare dhe Banka e Bujqësisë dhe e Zhvillimit të bëjnë në datën 10 janar 1993 likuidimin e gjithë detyrimeve të papaguara në lekë të ndërmarrjeve shtetërore që janë gjendje pranë tyre në këtë datë, nëpërmjet një llogarie speciale në emër e për llogari të Buxhetit të Shtetit.

2. Arkëtimet e realizuara si pasojë e këtij likuidimi, të kalojnë në llogari speciale të hapura për këtë qëllim për çdo subjekt të veçantë shtetëror, duke përfshirë edhe buxhetin e shtetit, Drejtorine e Sigurimeve Shoqërore dhe Institutin e Sigurimeve Shtetërore, dhe të mbahen të bllokuara.

3. Brenda datës 20 janar 1993, Banka Kombëtare e Shqipërisë dhe Banka e Bujqësisë dhe e Zhvillimit të raportojë në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë për të dhënat që dalin nga ky operacion.

4. Duke u mbështetur në të dhënat e raportuara nga Banka Kombëtare dhe Banka e Bujqësisë dhe e Zhvillimit, sipas pikës 3, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore të paraqesin brenda datës 10 shkurt 1993 në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë një analizë të gjendjes debitore e kreditore të ndërmarrjeve të sistemit të tyre, së bashku me mendimin e tyre për mbylljen e llogarive debitore e kreditore të çdo ndërmarrjeje të veçantë, si dhe ristrukturimin e ndërmarrjeve që rezultojnë me detyrime neto debitore.

5. Detyrimet debitore neto që rezultojnë në fund të kësaj ndërhyrjeje, do të vazhdojnë të mbeten detyrime të ndërmarrjeve.

Mënyra e trajtimit përfundimtar të tyre do të vendoset nga Këshilli i Ministrave brenda datës 28 shkurt 1993.

6. Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, Banka e Shqipërisë, Banka Kombëtare dhe Banka e Bujqësisë dhe e Zhvillimit ngarkohen për nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi